

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Kujdesi për dhëmbët

Shërbimi i Kujdesit Dentar Publik të Suedisë përqendrohet në ofrimin e kujdesit dentar parandalues dhe në shëndetin dentar të mirë.

Kujdesi dentar për të gjithë

Ka 24 klinika në 15 vende në rreth. Aktiviteti kryesor i Shërbimit Suedez Dentar Publik është shëndeti i përgjithshëm dentar i cili do të thotë kujdes për fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit.

Përlllogaritja e kostos

Ju keni të drejtën të merrni një përlllogaritje të përafërt të kostos përpara trajtimit. Dentistët kanë të drejtën t'ju kërkojnë të paguani për ekzaminimin dhe vlerësimin i cili përbën bazën e kësaj kostoje të përafërt.

Vizitat tek kujdesi i shëndetit

Të moshuarit, ose ata që janë sëmurë dhe me paaftësi fizike apo mendore kanë të drejtën që t'i vizitojë në shtëpi një higjienist dentar.

Fëmijët dhe adoleshentët

Kujdesi i shëndetit dentar është falës për fëmijët dhe adoleshentët deri në moshën 19 vjeç.

Kujdesi dentar i specializuar

Shërbimi i Shëndetit Dentar Publik të Suedisë ka pesë klinika dentare të specializuara në vend të cilat pranojnë pacientë me kërkesa të ndërlikuara për kujdes dentar.

E keni frikë dentistin?

Disa klinika kanë burime të posaçme që mund t'ju ndihmojnë.

Zgjedhje aktive e dentistit për fëmijët dhe adoleshentët

Rrethi Kronoberg lejon fëmijët dhe adoleshentët nga moshën 3 deri në 19 vjeç të zgjedhin në mënyrë aktive dentistin që ju pëlqen atyre. Ju mund të zgjidhni ndërmjet Shërbimit Publik Dentar të Suedisë, klinikave dentare private dhe dentistëve të tjerë privat që trajtojnë fëmijë dhe adoleshentë.

Kujdes dentar parandalues – çmim fiks për kujdesin dentar

Ju mund të merrni kujdes dentar me një çmim fiks. Shëndeti juaj dentar dikton koston e marrëveshjes tuaj dhe ajo është e vlefshme për një periudhë tre vjeçare. Më shumë informacion rreth asaj se çfarë është përfshirë në kujdesin dentar parandalues gjendet tek www.frisktandvardkronoberg.se ose flisni me dentistin tuaj.

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

Informohuni më tej rreth kujdesit të shëndetit dentar në www.1177.se/tema/tander. Këtu mund të gjeni edhe informacion të përkthyer.